Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!",

Zubejr ibën Avami tregon: Kur zbriti ajeti: "Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!", (Et Tekathur, 8) thashë: "O i Dërguari i Allahut, për çfarë kënaqësish do të pyetemi, kur ato janë vetëm dy të zezat: hurma dhe uji?" Profeti ﷺ tha: "Kjo do të ndodhë."

[Hasen] [Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe]

Kur zbriti ajeti: "Pastaj, atë Ditë, do të pyeteni për kënaqësitë (e kësaj bote)!" (Et Tekathur, 8) Pra, do të pyeteni për begatitë që ju ka dhënë Allahu. Zubejr ibn Avami (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha: "O i Dërguar i Allahut, për çfarë begatish do të pyetemi?! Përkundrazi, ato janë dy begati që nuk kanë ndonjë vlerë. Ato janë: hurma dhe uji!" Profeti ﷺ tha: "Ju do të pyeteni për begatitë, me gjithë këtë gjendje në të cilën jeni, sepse ato dyja janë nga begatitë madhështore të Allahut të Lartësuar.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/65075